



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1490/Prot.
13

Patos, më 03/08/2023

PROCESVERBALI I TAKIMIT 25 Korrik 2023

Vendi: "Bashkia Patos"

Ora e fillimit : 10:00

Ora e mbarimit : 12:30

Tema E Konsultimit: "Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024"

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18; Ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin Publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52 ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për Konsultimin Publik", si dhe VKB-së nr. 94 datë 19.12.2022 Mbi Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe Projekt Buxhetit Vjetor për vitin 2024.

Pjesëmarrës: Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro, Anëtarë të këshillit bashkiak, Sekretare e Këshillit Bashkiak znj. Refaela Xeba, Anëratë të Këshillit të Bashkisë Patos, Deputete e Qarkut Fier znj. Antoneta Dhima, Koordinatorja e Konsultimit Publik znj. Suzana Hysenaj, dhe Rreth 50 pjesëmarrës (Kryetarë të fshatrave, Banorë dhe Përfaqësues të Organizatave jo qeveritare)

Takimin hapet nga Sekretare e Këshillit të Bashkisë znj. Refaela Xeba: të nderuar pjesëmarrës, unë jam Refaela Xeba, Sekretare e Këshillit të Bashkisë Patos. Më lejoni tju falenderoj që i jeni përgjigjy ftesës sonë për të marrë pjesë në këtë dëgjese publike me temë: “Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”. Këshilli i Bashkisë Patos e organizon këtë proces në bazë të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe ligjit nr.139/2015 ‘Për Vetëqeverisjen vendore’. Jeni ftuar në këtë proces për të qenë sa më transparent dhe të drejtëpërdrejtë dhe ju bëj me dije se të gjitha ankesat , kerkesat apo sygjerimet tuaja të gjitha do të dëgjohen dhe do të trajtohen sipas ligjit. Duke ju falenderuar edhe një herë e deklaroj këtë dëgjese të hapur dhe fjalën po ia kaloj Kreyetarit të Bashkisë



**Sekretare e Këshillit të Bashkisë z.
Refaela Xeba**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishqyrtimin e kërkesave
prioritare për hartimin e Projekt
Buxhetit Afatmesëm 2024-2026
dhe kërkesave buxhetore për vitin
2024”**

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro : Pershëndetje, ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë dëgjese publike. Si fillim më lejoni tju prezantoj investimet e parashikuara për vitin 2023 dhe ato investime të cilat janë parë si prioritet për vitin 2024 dhe nëse ndokush prej jush mund të ketë propozime të tjera patjetër që mund ti shprehni, pasi jemi në fazën e rishqyrtimit të kërkesave buxhetore.

Për vitin 2023 në fshatin Margëllic është parashuar rruga e Lapidarit duke përfshirë edhe kanalizimin e ujrave të zeza. Në lagjen Mustafa Matohiti rruga te ish kopshti dhe rruga te Pajallarët. Në Dukas Breg do të ndërhyet në segmentin rrugor degëzimi në rrugën Late Bregu tek pallatet 2 katësh. Në lagjen 1 maj rruga Karafil Muskaj. Në Dukas Coban ndërhyrjet do të jene në rrugët Sulo Kamberi, Jakov Xoxe dhe Faslli Hoxha. Prap në Dukas në lagjen Aranitas ndërhyrje do të ketë në rrugën Erman Dano. Në Dukas 3 tek Perla do të ndërhyet në rrugët Naun Nasi vazhdim i Muskallarëve dhe degëzim i rrugës Sotir Xoxe. Në lagjen Grizë Lënginas ndërhyrje do të jenë në rrugët Selman Shpërdheja, Xhaferraj dhe Fontana.

rrugët e parashikuar për shtrim me rërë bituminoze janë në fshatin Dukas Breg Rruga tek Kisha, rruga në lagjen Banaj, rruga tek Kripallarët, rrugë në lagjen e Vresht dhe në lagjen 29 Marsi rruga për nga stallat e derrave, pas Albpetrolit.

Për vitin 2024 janë parashikuar ndërhyrje në segmentet rrugore si më poshtë

Në lagjen e Re rrugët të cilat janë parashikuar për ndërhyrje janë Ali Laze dhe Qerim Gropa, në lagjen 29 Marsi rruga Kamber Brezhani, në fshatin Gizë Lënginas Rruga e Dëshmorët e Prishtinës dhe në Dukas 3 tek Perla rrugët Sotir Xoxe dhe Degëzim i rrugës Rrapi Tikudy degëzime mjet të rëndësishme.

Investimet e parashikuara të dalin nga prioriteti tuaj për buxhetin 3-vjeçar 2024-2026 janë: Në lagjen e Redo të ndërhyet për rikonstruksionin e rrugës në lagjen e Re pranë përroit duke përfshirë edhe degëzimet e saj, pra cdo degëzim që ka rruga që të çon në cdo shtëpi do të ketë rrugën e shtruar me qëllim që të mos i kthehemi më këtij investimi gjithashtu do të ketë edhe kanalizim të ujrave të zeza. Investim tjetër është ndërhyrja për shtrimin e rrugës pas pallatit të Kulturës. Në lagjen 1 Maj, Rivitalizimi i bllokut para Pallatit të Kulturës, Rikonstruksioni i kopshtit me drekë. Në lagjen Naftëtari janë parashikuar dy ndërhyrje rivitalizimi i bllokut në lagjen Naftëtari dhe rehabilitimi dhe rikonceptimi i lulishtes pranë stadiumit. Në lagjen Margëllic është parashikuar ndërtimi i rrjetit KUZ dhe në qytetin e Patosit do të ndërhyet në sistemin e shesheve pranë pallateve. Padiskutim që ndërhyrja në kanalizimet e ujrave të zeza për zonat informale dhe ndërhyrja në rrjetin e ndriçimit duke shtuar linja të reja dhe riparimi i linjave ekzistuese mbetet prioritet. Këto janë investimet që do të bëhen deri në fundin e vitit 2023 si dhe parashikimet për buxhetin afatmesëm 2024-2026 duke marrë parasysh edhe kërkesat tuaja në takimet e mëparshme. Nëse keni ndonjë vërejtje sygjërim apo kërkesë ne jemi këtu për tu dëgjuar dhe mbajtur shënim pasi jemi në fazën ku mund të propozojmë kërkesa të reja.




Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimin e kërkesave
prioritare për hartimin e Projekt
Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe
kërkesave buxhetore për vitin
2024”**

Kryetari i fshati Margëllic z. Agron Faslliaj – ju dëgjova me vëmendje për të gjitha investimet që bashkia ka parashikuar por ne si fshat përveç problemeve të shumta që kemi është edhe mungesa e mjekut pasi Margëllici është një fshat me popullsi të konsiderueshme. Gjithashtu kemi një problem tjetër i cili lidhet me transportin publik ndaj kërkojmë të negocioni për orarin e furgonave që ofrojnë transportin publik pasi gjithë zona lartë është pa transport edhe ato mjete që janë lëvizin orar pa orar ose me orare të kufizuara




Kryetari i fshati Margëllic z. Agron Faslliaj

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Banor i fshati Grizë z. Myrto Paja - më lejoni që në radhe të parë tju uroj suksese në detyrën tuaj por në Grizë Lënginas cilat rrugë janë parashikuar për tu investuar nga bashkia pasi fshati kërkon shumë investim jo vetëm në rrugë në brendësi por edhe në kanalizime edhe hapje të rrugëve të parcelave



Banor i fshati Grizë z. Myrto Paja

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro : mbase nuk keni qenë i vëmendshëm gjithësesi në Grizë Lënginas për vitin 2023 janë parashikuar për shtrim më asfaltobeton rrugët Selam Shpërdheja, Xhaferraj dhe rruga Fontana ndërsa për vitin 2024 kemi parashikuar për ndërhyrje në rrugën Dëshmorët e Prishtinës dhe janë të gjitha rrugë të cilat do të shtrohen me asfaltobeton pasi nuk do të përdorim më rërën bituminoze duke parë që edhe cilësia e saj nuk është e mirë ndaj kemi gjykuar që investimet të bëhen të plota për të mos iu kthyer më si investim



Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimin e kërkesave
prioritare për hartimin e Projekt
Buxhetit Afatmesëm 2024-2026
dhe kërkesave buxhetore për vitin
2024”**

Banore e lagjes Mustafa Matohiti znj. Vito Resulaj- z Kryetar jam banuese në Mustafa Matohiti dhe kemi probleme me rrugët të cilat janë të dëmtuara. Sic e tha edhe kryetari i fshatit transporti është problem i madh për ne si banorë pasi le që është më orare të zgjatura pritje por pas orës tre nuk ka më mjet për në lagjen Mustafa Matohiti dhe të presësh me orë të tëra për të vajtur në shtëpi nuk më duket e arsyeshme. Kërkoj që të ndërhyet për sistemimin e shesheve te ato objektet e vjetra që kanë mbetur si gëmadhë të bëhet ndonjë lulishte kënd lojrash apo edhe mini park ku mund të qëndrojnë të moshuarit. Gjithashtu mungesa e mjekut është shumë problem




**Banore e lagjes Mustafa Matohiti
znj. Vito Resulaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimin e kërkesave
prioritare për hartimin e Projekt
Buxhetit Afatmesëm 2024-2026
dhe kërkesave buxhetore për vitin
2024”**

më parë vinte një herë në javë ndërsa tani nuk vjen fare mjeku ku do të venë njërezit transport nuk ka të vemi te mjeku të paktën të vij mjeku te ne.

Banor i fshatit Dukas z. Gaqi Gollosi – jam banues në fshatin Dukas Coban për aq sa thatë jemi dakord por ne kemi problemin e një ure e cila është e dëmtuar. Mund të ndërhyni për ta riparuar apo të bëni një urë të re




Banor i fshatit Dukas z. Naqi Gollosi

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Banor i lagjes së Re z. Musa Goxhaj – në radhë të parë më lejoni tju falenderoj që hapët rrugën kryesore dhe e bëtë dykalimshe pasi për të gjithë ka qenë një problem i madh. Qendra e qyteti ka goxha gjelbërim dhe doja të dija a ka sistem vadije për pemët dhe nëse nuk ka çfarë keni parashikuar për sistemin e vadijes pasi nuk dëgjova të flitej për këtë pjesë.




Banor i lagjes së Re z. Musa Goxhaj

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Kryetar i fshati Kuqar z. Islam Shpata – ju kryetar përmendët faktin e shtrimit të rrugëve me asfaltobeton duke mos përdorur rërrën bituminoze për shkak të cilësisë jo të mirë të saj. Unë e

kuptoj shumë mirë që asfaltoetoni është një investim i mirë për cdo rrugë të shtruar por ne me rërën bituminoze kemi mbyllur shumë rrugë qoftë edhe provizorisht ndaj shikojeni edhe një herë si mundësi vazhdimin e shtrimit të rrugëve me rërë bituminoze. Një problem që kemi është vazhdimi i procesit të azhornimit të tokave bujqësorë. Rruga e re që është shtruar ka sjellë lehtësi në qarkullimin rrugor për të gjithë banorët e fshatrave kuqar rusinjë dhe dukas duke bërë një miniunazë të vogël por do të lutesha të merren masa për vendosjen e sinjalistikës rrugore pasi rruga kalon përmes qendrave të banuara dhe vendosja e sinjalistikës do të ndihmojë në parandalimin e aksidenteve rrugore




Kryetar i fshati Kuqar z. Islam Shpata

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Banor i lagjes 1 Maj z. Bashkim Velçani – më lejoni si fillim t’ju shpreh urimet e mia në detyrën e marrë. Në dëgjesat e mëparshme ka propozuar ngirtjen e një tregu të mirfilltë përkatësish në lagjn 1 Maj te gaodina e ish komunales e cila prej vitesh qëndron aty e amortizuar. Përse të mos bëhet një minipazar dhe mesa dëgjova nga prezantimi juaj nuk është marrë arsysh si kërkesë.




Banor i lagjes 1 Maj z. Bashkim Velçani

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro – po thoni për godinën e ish komunales? Ai objekt është pronë private dhe nuk mund të ndërhyjmë sot për sot në një objekt që privat pa bërë shpronësimet nëse do të duam të ndërhyjmë aty. Padiskutim që nevoja e ngritjes së një tregu është domosdoshmëri por ne jemi në fazën e studimit të pozicionit gjeografik se ku do të ndërtojmë një treg.



Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Kryetar i fshatit Grizë z. Refat Shpërdheja – suksese kryetar për detyrën për fshatin Grizë Lënginas ju përmendët investim në katër rrugë por Griza ka akoma probleme të tjera ku mund të ndërhyet si psh rruga e varrezave kërkon ndërhyrje po kështu rrugët në brendësi të lagjeve janë të pashtruara dhe kërkoj të parashikohet shtrimi i rrugëve në brendësi të lagjeve. Kërkoj të punohet me pastrimin e kanaleve pasi edhe ura është e bllokuar. Gjithashtu rrugët e fshatit nuk kanë ndricim rrugor




Kryetar i fshatit Grizë z. Refat Shpërdheja

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Banor i fshatit Rerës z. Gjergji Hoxha- për fshatin Rerës nuk dëgjova anjë investim as për këtë vit dhe as për tre vitet e ardhshme. Fshati Rerës ka një problem të madh lidhur mbi varrezat publike dhe kërkoj të bëhet ndërhyrje urgjente. Infrastruktura në brendësi të fshatit është copë copë ndaj ju kërkoj që të shikoni mundësinë për të parashikuar ndërhyrje për shtrim të rrugëve me asfalt apo edhe mirembajtje të atyre ekzistuese me rërë bituminoze. Edhe ruga që të con në varrezat e fshati është shumë problematike. Fshati Rerës ka banesa të vjetra mbi 100 vjecare të shkohet mundësia për të hartuar një plan masash për rkonstriksionin e tyre me qëllim shfrytëzimin nga ana turistike pasi të gjithë po i kthehen traditës.




Banor i fshatit Rerës z. Gjergji Hoxha

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Banor i fshatit Grizë z. Rexhep Zanaj- Kërkoj që në lagjen Grizë Lënginas të ndërhyet për shtrimin e rrugës me asfalt në Saliaj, pasi rruga është e shtruar me cakull. Kemi një problem shumë të madh pasi vuajme mungesën e kanalizimit të ujrave të zeza dhe në rase se vonohet investimi për kanalizimin e ujrave të zeza ju duhet të merrni masa shtrënguese për detyrimin e popullatës për bërjen e gropave septike asi nuk mund të derdhen ujrat e zeza në sipërfaqe



Banor i fshatit Grizë z. Rexhep Zanaj

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro – lidhur mbi pyetjen që u bë mbi sistemin e vaditjes jemi duke punuar aktualisht para pallatit të kulturës dhe ish bashkisë për të sistemuar ujitjen dhe besoj se dotë mbyllet këtë vit por do të bëjmë ndërhyrje për të shtuar kapacitetin e depozitave për të patur më shumë ujë më qëllim sigurimin e sistemit të vaditjes të paktën për qendrën e qytetit

Banor i lagjes së Re z. Musa Goxhaj – kryetar mund të përdoren edhe burime të tjera alternative për të mustafaraj ka pus përse të mos shfrytëzohet

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro – unë po flas për pjesën lartë pasi i kemi linjat gati ndërsa ajo që je duke thënë është pronë private dhe duhet ti marrësh leje për përdorimin e tij. Lidhur mbi rrugët e parcelave kemi një mungesë të theksuar mjeteve teknologjike sic është skrepi dhe ekskavatori dhe janë shumë projekte që duhet të vazhdojnë dhe ne jemi të kufizuar përshkak të mungesës së këtyre mjeteve por po shohim mundësinë që brenda këtij viti të shtojmë kapacitetet e mjeteve me qëllim që ndërhyrjet të jenë më të shpeshta dhe në kohë reale. Lidhur mbi pjesën e sinjalistikës rrugore, normalisht jemi duke studiuar terrenin ku ka nevojë për sinjalistikë me qëllim kryerjen e blerjes pasi nuk bëhet vetëm për një segment rrugor por për të gjithë territorin e bashkisë. Rëra bituminoze aktualisht ka dalë me një cilësi të dobët dhe investimi me rrëre bituminoze në gjykimin tim është sa për të thënë se bëm investim ndaj kërkoj që investimet të bëhen me një cilësi të mirë dhe në parametra të duhura pra synimi jonë është që të kryejmë investime të plota për të cilat nuk ketë më nevojë t'ju kthyer prap si investim por gjithsesi mbetemi në diskutim të hapur lidhur mbi këtë pjesë


Rruga të ish komunalja për të bërë tregun ushqimo problemi është se atje nuk ka shumë hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e një treg në qoftë se do të ndërtohet një objekt është pallati dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e një objekti të ri. E kuptoj nevojën emergjente për një treg pasi vetëm treg nuk mund të quhet vendi ku aktualisht tregëtohet por ne jemi në fazë studimi për gjetjen e një vendi për ndërtimin e një tregu sa më afër për të gjitha lagjet e qyteti.. Rruga e varrezave në fshatin Grizë Lënginas do të shohim mundësinë për të sistemuar ashtu sic po vazhdon puna edhe për pastrimin e kanaleve që kalon në Grizë ne kemi filluar nga puna dhe

po pastrojmë pjesën e lënë nga bordi i kullimit. Pjesën e ndicimit e thashë që jemi duke ndërhyrë në sistemin e ndricimit rrugorë në të gjithë territorin e bashkisë

Varrezat në fshatin Rerës ne kemi planifikuar rrethimin e tyre dhe jo vetëm për Rerësin por për të gjitha varrezat e ndodhura në territorin e Bashkisë qrofshin ato në Zharrëz apo Ruzhdie duke filluar nga ky vit me blerjen e bazës materiale për rbrjen e rrethimit të tyre edhe aty ku ka nevojë për riparime do të ndërhyjmë.

Lidhur mbi linjën e transportit Patos-Mustafa Mothiti do të shkohim kontratën si janë përcaktuar kushtet nga ana e operatorit dhe padiskutim qëdo të shohim mundësinë për vendosjen e orareve të përshtatshme për banorët.

Në lgjen e re do të ndërhyet për pastrimin e përroit dhe do të shohim për rivitalizimin e gjithë zonës përreth tij



Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimin e kërkesave
prioritare për hartimin e Projekt
Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe
kërkesave buxhetore për vitin 2024”**

Sekretare e Këshillit të Bashkisë znj. Refaela Xeba: faleminderit Kryetar për gjithë sqarimin e nevojshëm. Nëse ndokush ka ndonjë sygjërim apo kërkesë për t'u trajtuar? Mqse jo e konsidderojmë këtë denacë konsultative të mbyllur. Edhe një herë faleminderit.

Konceptoi:

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj

Pranoi:

Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba

Foto të dëgjesës publike me temë: “Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Patos me 25.07.2023

RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESAËM 2024-2026”
DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024”

LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:

Nr	Emër	Mbiemër	Qyteti / Fshati	Profesioni/ Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Metkuf	Zogaj	Griç	Bujk	06857159114	[Signature]
2	Haki	Gaidoshi	Bohim	Bujk	0688778965	[Signature]
3	Çarpi	Çetković	Dukas	Personist	06864558615	[Signature]
4	Musa	Çetković	Çetković	vetëpunës	0684312111	[Signature]
5	Asim	Beqaj	Wafletë	Zemri	0692947640	[Signature]
6	Almir	Beqaj	Griç	Personist	—	[Signature]
7	Beqaj	Beqaj	Griç	Personist	0682457537	[Signature]
8	Almir	Miftari	Dukas	K. Sindikate/Presid	0688410638	[Signature]
9	Novruz	Çetković	Griç	Negotatar	06995213642	[Signature]
10	Yulion	Çetković	Griç	Mekanik	0688179001	[Signature]
11	Avron	Çetković	Çetković	K. Pshori	0692489939	[Signature]
12	Almir	Çetković	Bens	J. / Fshati	0683552968	[Signature]

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 “Përpunimi për qëllime shkencore dhe statistike” Të dhënat personale, të mbledhura për qëllime qëlloje, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistike, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të individit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Patos me 25.07.2023

RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026"
DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024"

LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:

Nr	Emër	Mbiemër	Qyteti / Fshati	Profesioni / Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Ardit	Maqelid	Zharrëz	Ekonomist	0692126118	
2	Edhe	Maqelid	Patos	-/-	0683949375	
3	Paola	Centra	Patos	Specialiste Integrimi EU		
4	Artidol	Hoxha	Patos	Drejtore Shprehimore dhe dispones	067684770	
5	Yesjana	Senaluar	Patos	Specialiste Migrations	0693822520	
6	Trusi	Khelaj	Patos	Specialiste Integrimi	0684770444	
7	Yshant	Shumali	Patos	Dr. Poliklinikë	0693319702	
8	Edhe	Centra	Patos	Dr. Integrimi	066735211	
9	Alba	Spiloshi	Patos	Dr. Kërkimi Social	0686235260	
10	Olivera	Greppa	Patos	Spedimentor info publik	0689490612	
11	Rejsele	Yeha	Patos	GERRETA KESHILL	0692195181	
12	Luiza	Qendrore	Patos	Pensioniste	0687187666	

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 "Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistike" Të dhënat personale, të mbledhura për qëllime të qartë, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistike, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetaria, literaturë ose artistike. Përishtohet nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Patos me 25.07.2023

LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:

RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026”
DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024”

Nr	Emër	Mbiemër	Qyteti / Fshati	Profesioni / Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Marin	Alkalla	Fier	gazetar UGSH	0686930000	
2	Drëta	Arsem	Patos	K K Patos	0682147187	
3	Smirell	Harroj	Patos	Alpkol.	0692882453	
4	Veir	Domkollaj	Patos	KVR	0654347989	
5	Haris	Uceaj	Detkos	Sek. Sek. S&P	0696363738	
6	Mirretok	Pesellaj	Patos	Grupor i shqyrtimit	06945420362	
7	Refat	Perstaj	Lezha e Re	Shoqëria e Re	0699365069	
8	ERAY	Hoxhaji	RRER	PA PUN	0693918298	
9	Alexander	Koremanaj	RRER	Shkolltar	0694636663	
10	Syberfi	Harroj	RRER	Prizor	0696404967	
11	Muhamet	Kalipi	Patos & Hax	aut	069688946	
12	Emmelinde	Imery	PATOS	Njelue	0698572166	



Patos me 25.07.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:

RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026”
DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024”

Nr	Emër	Mbiemër	Qyteti / Fshati	Profesioni/ Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Hygan	Shpendheje	Gaz	Pensierist	0683220147	
2	Refol	Shpendheje	-	Kryetar	0686563400	
3	Yllozi	Dasay.	L.1 May - Rotos	Deshilltare	0692450048	
4	Edita	Mymaj	Rotos	Deshilltare	0699205092	
5	Erabel	Sepele	Zhanëz	Kryhilltar.	0683583350	
6	Agjet	Bjers	Rozimjo	K. Fjalit	0692290891	
7	Asim	Shpita	Kyral	W/mbetar	0696359424	
8	Rondela	Shpita	Suqon	Deshilltar	0684354620	
9	Suela	Hoxhaj	Lagja 29 Marsi, Rotos	Keshilltare	0694407813	
10	Ufo	Resulaj	Lagja 11 Motori	Skritse	0685287232	
11	Deilaut	Bençaj	Lagja 11 BE	Inxhinjer	0696134333	
12						



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Patos me 25.07.2023

LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:

RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026”
DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024”

Nr	Emër	Mbiemër	Qyteti / Fshati	Profesioni / Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Boreta	Mucati	Patos	Dr. Planifikimi shërbime	0693257208	Quwest
2	Muqta	Muqta	Patos	Finance	0683272407	Quwest
3	Suzana	Mysenaj	Patos	Koordinatori	0694881460	Quwest
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						